



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**  
Nr. \_\_\_\_/2020

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998 “KODI RRUGOR I**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR\***

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

**Neni 1**

Kudo në përmbajtjen e ligjit, shprehja “kontrolli teknik vjetor dhe periodik” zëvendësohet me shprehjen “kontrolli teknik”.

**Neni 2**

Në nenin 79, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi :

“Prodhuesit dhe përfaqësuesit e tyre, ti transmetojnë qendrave të kontrollit teknik, informacion mbi sistemet dhe pajisjet e mjeteve për të cilat kryhet kontrolli teknik, në mënyrë të vazhdueshme, në kohë, pa kufizim, me qasje të lehtë dhe jodiskriminuese. Informacioni të vihet në dispozicion 6 muaj pas regjistrimit të mjetit.

Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në pikat 6 dhe 8 të këtij neni, për të cilat informacioni të transmetohet sipas kërkesës dhe pa vonesa.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik. Për mjetet e reja me motor, kontrolli teknik do të kryhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit parë. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo dy vjet. Mjetet e kategorisë M<sub>1</sub>, të përdorura si taksi dhe ambulanca si dhe mjetet e kategorive M<sub>2</sub>, M<sub>3</sub>, N<sub>2</sub>, N<sub>3</sub>, O<sub>3</sub>, dhe O<sub>4</sub>, kryejnë kontroll teknik çdo vit. Mjetet e reja të kategorisë M<sub>1</sub>, të përdorura si taksi dhe ambulanca si dhe mjetet e kategorive M<sub>2</sub>, M<sub>3</sub>, N<sub>2</sub>, N<sub>3</sub>, O<sub>3</sub>, dhe O<sub>4</sub>, kryejnë kontroll teknik brenda një viti nga data e regjistrimit të parë dhe më pas çdo vit.”

3. Pika 4 shfuqizohet.

4. Në pikën 8, shprehja “në zyrën kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” zëvendësohet me shprehjen “në qendrën e kontrollit teknik”.

---

\* Ky ligj përaftron Direktivën 2014/45/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të 3 Prill 2014 mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, FZ L. 127, 29.04.2014, f. 59 dhe Rregulloren e zbatimit të Komisionit BE 2019/621 e 17 Prill 2019 mbi informacionin teknik të nevojshëm për testimin e vlefshmërisë së aftësisë në rrugë për automjetet/artikujt që do të testohen, duke përdorur metodat e rekomanduara të testimit dhe duke vendosur rregulla të detajuara në lidhje me formatin e të dhënave dhe procedurat për aksesimin në informacionin përkatës teknik, FZ L. 108, dt. 23.4.2019.

### **Neni 3**

Ngarkohet ministri përgjegjës për transportin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 79, pika 1 të Kodit Rrugor.

### **Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrirja e efekteve të tij fillon më 1 Janar 2021.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**